



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Tiranë më, 18.1.2016

Lënda: Raporti i monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit të ILDKPKI, për vitin 2015.

Drejtuar: **Znj. Gelardina PRODANI
NËPUNËS I PARË AUTORIZUES
MINISTRIA E FINANCAVE**

TIRANË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2015, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa nëpunësve Publike”, i ndryshuar dhe Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar .

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në mbështetje të Ligjit nr.160/2014, datë 27.11.2014 “Për Buxhetin e vitit 2015”, Udhëzimit nr.2, datë 9.1.2015, « Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015 » dhe Aktit Normativ nr.1, datë 29.7.2015, Aktit Normativ nr.2, datë 15.12.2015 dhe Aktit Normativ nr.3, datë 28.12.2015, “Për disa ndryshime në Ligjin 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, i është akorduar një fond buxhetor i rishikuar, prej 107 milionë e 829 mijë e 275 lekë.

Gjithsej fondi buxhetor i rishikuar përbëhet nga:

Fondi i Pagave 66.3 milion (zëri 600)

Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 9.7 milion lekë (zëri 601)

Fondi për Shpenzime Operative: 15 milion e 280 mijë lekë (zëri 602)

Fondi për transferime të brendshme: 29.275 mijë lekë, (zëri 604)

Fondi për Transferime korrente: 240 mijë lekë (zëri 606)

Fondi për Investime: 16 milion e 280 mijë lekë (zëri 231)

Buxheti është akorduar për programin “Menaxhim, Administrim, Planifikim” dhe është i mbështetur në Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2015-2017.

Mbështetur në buxhetin e vitit 2015 të ndryshuar, fondi i planifikuar buxhetor është vënë në funksion të objektivave për forcimin e mëtejshëm të instrumenteve të hetimit të thelluar administrativ, të deklarimit të kontrollit të pasurive dhe zhvillimin e instrumentave për

parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave të personave të zgjedhur, nëpunësve publikë dhe zyrtarëve të tjerë. ILDKPKI në mbështetje të burimeve financiare në dispozicion ka realizuar objektivat e parashikuara, në funksion rritjes së cilësisë së kontrollit të interesave private dhe parandalimit të konfliktit të interesit, ku ka përcaktuar qartë politikat institucionale, qëllimet dhe objektivat të cilat lidhen me zbatimin e politikave buxhetore, me qëllim realizimin e Misionit të ILDKPKI, në përputhje me objektivat prioritare të institucionit.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të Udhëzimit nr.2, datë 19.1.2015, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015", për periudhën e raportuar, Inspektorati i Lartë ka realizuar vlerën buxhetore në 104,196,102 lekë leke ose 96.63% të fondit të planifikuar të rishikuar për vitin 2015.

Llog. Ek	Peshkrimi	Plani Buxheti vjetor 2015	Plani Buxheti vjetor 2015 i Rishikuar	Buxheti I realizuar viti 2015	Realizimi % si 12-Mujor
600	Fond Page	76,100,000	66,300,000	65,588,595.5	98.93%
601	Kontrib. Sig. Shoq. & Shëndetësore	8,900,000	9,700,000	9,299,845.5	95.87%
602	Shpenzime operative	25,560,000	15,280,000	13,057,113.4	85.45%
604	Transferime korente te brendshme		29,275		0.00%
606	Transferime per financim transporti	240,000	240,000	240,000.0	100.00%
231	Investime	11,000,000	16,280,000	16,010,547.6	98.34%
	T o t a l I	121,800,000	107,829,275	104,196,102.0	96.63%

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, (zeri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Për vitin 2015, numri mesatar i punonjësve është realizuar 57 vetë, nga 60 vetë të miratuar.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë, është realizuar për numrin faktik të punonjësve në vlerën 65,588,595.5 lekë ose 98.93% e fondit të planifikuar për vitin 2015 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 9,299,845.5 lekë ose 83.3% e planifikimit për periudhën respektive.

Vlera e përcaktuar e këtij fondi ka ardhur si rezultat i kryerjes së procedurave të rekrutimit, në mbështetje të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, të ndryshuar, në zbatim të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin Civil", i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në zbatim të tij

Fondi për shpenzime në zerin investime (zeri 231),

Vlera e përgjithshme e planit të fondit të investimeve për vitin 2015 në mbështetje të shtesave të miratuara me Aktin Normativ nr.1, është 16 milion e 280 mijë lekë. Për periudhën respektive ky fond është prokuruar 100% dhe realizuar gjithsej në vlerën 16,010,547.6 lekë, ose 98.34% e planit vjetor të rishikuar.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi dhe të planifikimit në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2015, të ndryshuar, për këtë zë shpenzimi ka prokuruar fondet e planifikuara, për fondet e investimeve të vëna në dispozicion si;

1. Fondi i investimeve me objekt "Blerje pajisje kompjuterike dhe elektronike", miratuar si produkt nga Ministria e Financave, është prokuruar në vlerën 5,896,388 lekë me tvsh, fituar nga firma "Infosoft Sistems" shpk me procedurën kërkesë për propozim. Likujdami është kryer në mbështetje të kontratës së lidhur ndërmjet palëve.
2. Fondi i investimeve me objekt "Blerje automjeti", miratuar si produkt nga Ministria e Financave në vlerën 4 milion lekë, është prokuruar dhe realizuar në vlerën 3,990,000 lekë lekë me tvsh, fituar nga firma "Albanian Motors" shpk me procedurën kërkesë për propozim. Likujdami është kryer në mbështetje të kontratës së lidhur ndërmjet palëve.

3. Fondi i investimeve me objekt “Blerje Kompjutera”, miratuar si produkt nga Ministria e Financave në vlerën 1,003,612 lekë, është prokuruar dhe realizuar në vlerën 993,000 lekë me tvsh, fituar nga firma “Atom” shpk me procedurën kërkesë për propozim. Likujdimi është kryer në mbështetje të kontratës së lidhur ndërmjet palëve.
4. Fondi i investimeve me objekt “Blerje Central Telefonik”, miratuar si produkt nga Ministria e Financave në vlerën 2,300,000 lekë, është prokuruar në vlerën 2,184,999.6 lekë me tvsh, fituar nga firma “SYNAPSE ATS” shpk me procedurën kërkesë për propozim. Likujdimi është kryer në mbështetje të kontratës së lidhur ndërmjet palëve.
5. Fondi i investimeve me objekt dhe “Blerje orendi Zyre”, miratuar si produkt nga Ministria e Financave në vlerën 2,240,000 lekë, është prokuruar dhe realizuar në vlerën 2,146,560 lekë me tvsh, fituar nga firma “Muça” shpk me procedurën kërkesë për propozim. Likujdimi është kryer në mbështetje të kontratës së lidhur ndërmjet palëve.
6. Fondi i investimeve me objekt “Blerje kondicioner”, miratuar si produkt nga Ministria e Financave në vlerën 120,000 lekë, është realizuar si likujdim në muajin dhjetor me procedurën e blerjeve të vogla në vlerën 114,000 lekë.
7. Fondi i investimeve me objekt, Blerje pajisje elektronike” miratuar si produkt nga Ministria e Financave në vlerën 620,000 lekë, është prokuruar dhe realizuar në muajin dhjetor në vlerën 585,600 lekë me tvsh, fituar nga firma “Real Com” shpk me procedurën kërkesë për propozim. Likujdimi është kryer në mbështetje të kontratës së lidhur ndërmjet palëve.

Fondi per shpenzime në zerin Mallra dhe Shërbime (zeri 602),

Për periudhën respektive, për këtë zë të shpenzimeve, është realizuar gjithsej vlera prej 13,057,113.4 lekë ose 85.45% e fondit të rishikuar vjetor, duke respektuar dispozitat ligjore ne fuqi.

Duke marrë në konsideratë udhëzimin nr.21, datë 31.7.2015, “Për disiplinimin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2015” të Ministrisë së Financave, realizimi i këtij zëri për periudhën respektive është i lidhur me realizimin e kërkesave më të nevojshme dhe imediate në zbatim të objektivave prioritare, të cilat lidhen me funksionim normal të institucionit dhe me një menaxhimin me efektivitet të fondeve të miratuara.

Për vitin 2015, në realizimin e shpenzimeve operative, Inspektorati i Larte është mbështetur në një shperndarje sa më racionale të kërkesave në harmonizimin e nevojave të ILDKPKI, me burimet financiare në dispozicion, në funksion të përmirësimit tërësor të infrastrukturës institucionale, në funksion të rritjes së cilësisë së kontrollit të interesave private dhe me zbatimin e politikave buxhetore përmes përdorimit ekonomik dhe eficient të burimeve financiare.

Për vitin 2015, realizimi i shpenzimeve në këtë zë të planifikimit buxhetor, është mbështetur në realizimin e kërkesave të cilat lidhen me;

- Në realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa, energji elektrike, uje, shërbime postare e telefonike, në funksion të një veprimtarie normale institucionale të cilat për periudhën e raportuar janë realizuar 100% të fondit të vitit 2015.
- Realizimin e shpenzimeve për blerje materiale e shërbime, është kryer sipas nevojave konkrete, për krijimin e kushteve të një aktiviteti normal institucional.
- Verifikimin dhe hetimin administrativ të interesave private të zyrtarëve brenda vendit.
- Forcimin e bashkëpunimit dhe mbështetjes ndaj shoqërisë civile, medias dhe publikut të gjerë për informacionet e dhëna për rastet e denoncimit të shkeljes së ligjit për deklarimin e interesave private pasurore, si dhe për rastet e identifikimit të konfliktit të interesave dhe abuzimin me pushtetin për shkak të përfitimeve jo ligjore për zyrtarët dhe personat e lidhur me ta.
- Forcimit të mekanizmave investigues për pasuritë e paluajtshme në terren dhe interesave privatë të zyrtarëve brenda vendit.

- Rritjes së numrit të hetimeve administrative të iniciuar kryesisht, nga denoncimet e qytetarëve , shoqërisë civile, medias , biznesit etj

Për vitin 2015, ILDKPKI ka realizuar prokurimet me tender me procedurën kërkesë për propozim, sipas objekteve dhe konkretisht është prokuruar;

- 1) Fondi me objekt “Shërbim me roje civile”, prokurimi i të cilit është realizuar 76% e fondit limit të planifikuar, fituar nga subjekti privat “Nazeri 2000” shpk, në vlerën 2,533,114 lekë me tvsh. Likujdimi është kryer cdo muaj, sipas kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, datë 5.3.2015.
- 2) Fondi me objekt “Blerje Kancelari”, prokurimi i të cilit është realizuar 76% e fondit limit të planifikuar, fituar nga subjekti privat “Infosoft Office” sha, dhe likujduar në vlerën 684,000 lekë me tvsh.
- 3) Fondi me objekt “Blerje tonera për printer dhe fotokopje”, prokurimi i të cilit është realizuar 79% e fondit limit të planifikuar, fituar nga subjekti privat “Infosoft Office” sha, në vlerën 1,579,939 lekë me tvsh. Likujdimi është kryer në mbështetje të kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, datë 22.05.2015.
- 4) Fondi me objekt “Mirmbajtje dhe riparime, pjesë këmbimi për automjete”, prokurimi i të cilit është realizuar 70.7% e fondit limit të planifikuar, fituar nga subjekti privat “Kombinat Service” shpk, në vlerën 707,640 lekë me tvsh. Likujdimi është kryer në vlerën 525,240 lekë, ose 74.22%, në mbështetje të kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, datë 30.06.2015 dhe kushteve teknike të automjeteve të ILDKPKI.
- 5) Fondi me objekt “Blerje karburant”, është prokuruar me procedurën kërkesë për propozim, në vlerën 1,080,000 lekë me tvsh, fituar nga subjekti privat “BOLV-OIL”, në vlerën 1,080,000 lekë ose 100% e fondit limit të planifikuar. Likujdimi është kryer në mbështetje të kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, datë 15.7.2015.

Gjatë vitit 2015 , shpenzimet janë realizuar ne permbushjen e detyrimeve me shtetin si posta, energji, uje, telefoni e tj.

Gjithashtu janë realizuar me blerje të vogël, sipas procedurës elektronike, prokurimi dhe realizimi i shërbimeve me kontrata të lidhura, për abonim në shtyp, blerje siguracione, larje automjete, shërbime për mirëmbajtje të pajisjeve të zyrave, kondicionerë, ashensor, gjenerator e tj. Likujdimi është kryer, në mbështetje të specifikimeve teknike të sanksionuara në mareveshjet dypalëshe. Përsa i përket shpenzimeve për blerje mallra të natyrave të ndryshme, institucioni ynë për vitin 2015, është mbështetur në nevojat konkrete dhe dispozitave ligjore.

Shpenzimet e domosdoshme të planifikuara dhe të miratuara gjejne realizim si blerje materiale dhe shërbime te ndryshme, në Regjistrin e Prokurimeve Publike të ndryshuar.

Realizimi i te ardhurave nga veprimtaria e ILDKPKI.

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI, vijnë kryesisht nga;

- 1) Arkëtimi i gjobave të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, nga zyrtarë subjekt të ligjit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive, të institucioneve të ndryshme, të cilat vitn 2015, janë 165 raste, në vlerën 21,350,000 lekë.
- 2) Zyrat Përmbartimore të rretheve për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave, për gjobat e vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore nga zyrtarë subjekt të ligjit. Për vitin 2015, janë ekzekutuar tërësisht gjithsej 72 raste, në vlerën 5,411,000 lekë, nga të cilat 60 raste në vlerën 4,561,000 lekë kanë kaluar në llogarri të të ardhurave të ILDKPKI. Arkëtimi në favor të ILDKPKI, i 12 rasteve të tjera, të cilat përbëjnë vlerën 850,000 lekë, është në proces likujdimi.
- 3) Të ardhura të tjera të cilat për periudhën respektive, janë në vlerën 14,972 lekë.

Gjithsej të ardhurat të arkëtuara për vitin 2015, janë në vlerën 25,925,972 lekë. Krahasuar me periudhën e vitit 2014, realizimi i të ardhurave është rritur 3.41 herë.

Të gjitha këto të ardhura, të realizuara në zbatim të ligjeve organike mbi të cilat funksionon Inspektorati i Lartë dhe të VKM nr.432 dt.28.06.2006 “Mbi të ardhurat në Institucionet Buxhetore”, kalojnë në Buxhetin e Shtetit në masën 100%.

ILDKPKI, për periudhën në vazhdim në mbështetje të kërkesave në rritje, për përmirësim e mëtejshëm të punës në zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara, do të zbatojë me korrektesi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji për deklarimin e interesave private periodike (të pasurive) dhe parandalimin e konfliktit të interesave private të zyrtareve, si dhe legjislacionin financiar në fuqi.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Flori KARAJ



Raportet e Monitorimit

Buxheti 2015

Shtojca Nr.7: Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve Buxhetorë

ne 000 leke

Institucioni		Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit			Kodi i Grupit 76
Programi		Totali I Shpenzimeve			
Artikulli		PBA	Buxhet i	Fakti - 12-	Diferenca
kodi	Emri	2015	Rishikuar Akti-Normativ	Mujori I Viti 2015	2015
600	Paga	76,100.0	66,300.0	65,588.6	711.40
601	Sigurime Shoqërore	8,900.00	9,700.0	9,299.8	400.20
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	25,560.00	15,280.0	13,057.1	2,222.90
603	Subvencione				-
604	Transferta Korente të Brendshme		29.27		29.27
605	Transferta Korente të Huaja				-
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	240.00	240.0	240.00	-
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	110,800.00	91,549.3	88,185.5	22,614.50
230	Kapitale të Patrupëzuara				
231	Kapitale të Trupëzuara	11,000.00	16,280.0	16,010.6	269.40
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale	11,000.00	16,280.0	16,010.6	269.40
Totali	Korrente dhe Kapitale	121,800.00	107,829.27	104,196.1	3,633.17
Jashte Buxhetore			0.0	0.0	-
Totali (korrente + kapitale + jashte buxhetore)		121,800.00		104,196.10	3,633.17

Drejtesesi I	Emri:	Flori KARAJ	Sekretari i	Emri:	Flori KARAJ
Ekipit Menaxhues Te Programit	Nenshkrimi		Pergjithshem	Nenshkrimi	



Raportet e Monitorimit

Buxheti 2015

Shtojca Nr.8: Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve

ne 000 leke

Institucioni		Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit			Kodi i Grupit 76		
Programi	Planifikim, Menaxhim ,Administrim			Totali I Shpenzimeve			
Programi		PBA PLAN 2015	Buxhet i Rishikuar 2015	Buxheti Perfundimtar 2015	Fakti 12-mujori 2015	Diferenca 2015	
Titulli	Emri						
01110	Planifikim, Menaxhim , Administrim	121,800.00	107,829.27	107,829.27	104,196.10	3,633.17	
Totali		Shpenzime tw miratuara	121,800.00	107,829.27	107,829.27	104,196.10	3,633.17

Sekretari i Pergjithshem	Emri:	Flore KARAJ
	Nenshkrimi	
	Data	18.1.2016



Raportet e Monitorimit

Buxheti 2015

Shtojca Nr.9 "Raporti i Realizimit të Rezultateve të Programit

ne 000 leke

Institucioni	Inspektorati i Larte i deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit						Kodi i Grupit	76
Programi	Planifikim, Menaxhim ,Administrim		Titulli	01110				
Kodi		Njesi	Sasia	Sasia	Realizimi			
Rezultatit	Emri i Rezultatit	Matese	e Planifikuar	prokuruar	Plotesisht	Pjeserisht	Aspak	Komente
M760012	Pajisje kompjuterike dhe elektronike	000/leke	5,996,388	5,996,388.0	5,996,388.0			Realizuar
M760034	Blerje Automjeti	000/leke	4,000,000	4,000,000.0	3,990,000.0			Realizuar
M760036	Blerje kompjutera	000/leke	1,003,612	1,003,612.0	993,000.0			Realizuar
M760034	Blerje Pajisje Elektronike	000/leke	620,000	620,000.0	585,600.0			Realizuar
M760021	Blerje Orendi Zyre	000/leke	2,240,000	2,240,000.0	2,146,560.0			Realizuar
M760037	Blerje Central Telefonik	000/leke	2,300,000	2,300,000.0	2,184,999.6			Realizuar
M760038	Blerje kondicionerë	000/leke	120,000	120,000.0	114,000.0			Realizuar
Totali (kapitale)			16,280,000.0	16,280,000.0	16,010,547.6			

Drejtuesi I Ekipit Menaxhues Te Programit	Emri:	Flori KARAJ	Sekretari i Pergjithshem	Emri:	Flori KARAJ
	Nenshkrimi			Nenshkrimi	
	Data:	18.1.2016		Data:	18.1.2016



Raportet e Monitorimit

Shtojca Nr.10: Raporti I i Shpenzimeve Faktike te Programit sipas Rezultateve

Institucioni		Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit				Kodi i Grupit	76	
Programi		Planifikim, Menaxhim ,Administrim		Titulli	01110			
Kodi Rezultatit	Emri I Rezultatit	Shpenzimet e Rezultatit				Kosto per njesi		
		PBA Plan 2015	PI.Buxheti Fillestar 2015	PI.Buxheti Rishikuar 2015	Fakti 12-Mujorii prokur	Kosto per njesi Plan 2015	Kosto per njesi Fakt 2015	Shpjegime
M760012	Pajisje kompjuterike dhe elektronik	6,850	6,850	5,996,388	5,996,388.0	297.8	260.7	Kursime gjat prc.Prok
M760034	Blerje Automjeti	4,000	4,000	4,000,000	3,990,000.0	4,000.0	3,990.0	Kursime gjat prc.Prok
	Mirmbajtje Sistemi Hidaa.CMS	150	150	-				
M760036	Blerje Kompjuter			1,003,612	993,000.00	1,003.6	993.0	Kursime gjat prc.Prok
M760034	Blerje Pajisje Elektronike			620,000	585,600.0	310.0	292.8	Kursime gjat prc.Prok
M760021	Blerje Orendi Zyre			2,240,000	2,146,560.0	37,966.1	36,382.3	Kursime gjat prc.Prok
M760037	Blerje Central Telefonik			2,300,000	2,184,999.6	2,300.0	2,185.0	Kursime gjat prc.Prok
M760038	Blerje kondicionerë			120,000	114,000.0	120.0	114.0	Kursime gjat prc.Prok
		11,000.0	11,000.0	16,280,000.0	16,010,547.60			

Drejtuesi I Ekipit Menaxhues Te Programit	Emri:	Flori KARAJ	Sekretari i Pergjithshem	Emri:	Flori KARAJ
	Nenshkrimi			Nenshkrimi	
	Data:	18.1.2016		Data:	18.1.2016

